

Lajmërim për qytetarët e huaj

*Deklarim i banimit të zakonshëm
(ai sensi dell'art 7 D.P.R. 223/89)*

Njoftohen qytetarët e huaj, ose qytetarët që nuk i përkasin shteteve të B.E. të regjistruar në Gjendjen Civile të Komunës së Pratos, që duhet të rinovojnë *Deklarim në lidhje me banimin e tyre të zakonshëm brenda 60 ditëve nga terheqja e lejes së qëndrimit të rinovuar/përditësuar.*

Për këtë qëllim qytetarët e huaj që nga data e këtij lajmërimi kanë rinovuar/përditësuar lejen e tyre të qëndrimit do të mund të paraqiten pranë Zyrave të komunale të poshtë shënuara:

- **Anagrafe Centrale**, piazza Cardinale Niccolò 13 – Prato:
E hëne dhe e enjte nga 15.00 deri 7.00
Merrni numrin nga butoni i verdhe “Servizi Anagrafici”
- **Servizio Immigrazione Politiche tempi e spazi e Pari opportunità**, Via Roma 101 – Prato
E hëne dhe e enjte nga 09.00 - 13.00 dhe 15.00 – 17.00
E marte dhe e premte 09.00 – 13.00
Merrni numrin nga butoni “A – Informazioni”

Qytetarët do të duhet të paraqitet pranë këtyre zyrave të pajisur me origjinalin e lejeve të qëndrimit të tyre të rinovuar/përditësuar origjinale (edhe të familjarëve me të cilët jeton) dhe dokument identifikimit.

Deklarimi i banimit të zakonshëm, pranë zyrave të lart përmendura, mund edhe të dërgohet me postë, së bashku me fotokopje të dokumentit të identitetit edhe fotokopje e autentikuar e lejes së qëndrimit të rinovuar/përditësuar, tek Zyra e protokollit të Komunës së Pratos – p.zza del Pesce n.1 . 5910 Prato, duke rregulluar mbi zarf “contiene dichiarazione di dimora abituale”. Në rast se dërgohet me postë formulari mund të shkarkohet nga faqja e internetit të Komunës së Pratos në adresën www.comune.prato.it/identità.

Ky lajmërim u drejtohet vetëm atyre që zotërojnë lejen e qëndrimit të rinovuar/përditësuar dhe jo atyre që zotërojnë kuponin e rinovimit/përditësimit të lejes së qëndrimit lëshuar nga zyrat e Postave Italiane Spa.

Prato, 30 tetor 2010

Drejtori i Shërbimeve Demografike